



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agjencia Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 22.06.2020 Ref.: 573/20D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 80-të, të mbajtur më 01 Prill 2020, mori:

V E N D I M

I. Tërhiqet akreditimi i programit të studimit të Kolegjit "Dardania":

- Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, BA, 180 ECTS

II. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Agjencia e Kosovës për Akreditim ka kërkuar nga të gjitha institucionet që të bëjnë deklarinë e stafit në platformën e-akreditimi, deri më datën 31 tetor 2019.

Pas deklarinës të stafit akademik të IAL-ve, AKA ka filluar me verifikimin e dokumentacionit të tyre me qëllim të konfirmimit të plotësisë apo jo të kriterëve ligjore për secilin program të studimit. Në mbledhjen e mbajtur më 01 prill 2020, KSHC analizoi të gjithë dokumentacionin e stafit akademik të vendosur si bartës të programeve nga Kolegjin Dardania. Pasi analizoi të dhënat rreth numrit të stafit dhe fushat e studimit për secilin program të studimit, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Sipas pikës një (1) të nenit 21, të UA për Akreditim, "AKA e rezervon të drejtën të monitorojë dhe të kontrollojë cilësinë e institucioneve të akredituara në çfarëdo kohe me paralajmërim". Sipas pikës dy (2), "AKA mund të rishqyrtojë akreditimin e dhënë në çfarëdo kohe dhe /apo më pas të tërheq vendimin e saj për akreditim nëse kushtet e dhëna me rastin e akreditimit janë shkelur".

Sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (15/2018, datë 28.09.2018), Institucionet e Arsimit të Lartë: "Për programet e studimit të cilat shpijnë deri tek marrja e një diplome shkencore Bachelor dhe Master, kërkesat për stafin akademik janë për çdo grup të studentëve (të përcaktuar sipas statutit të

IAL) dhe për çdo 60 ECTS kredi të programit studimit, institucioni duhet të ketë të paktën një (1) staf me marrëdhënie të rregullt të punës me titull PhD nga fusha e programit të studimit”.

Ndërsa në nenin 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, thuhet: “IAL-të duhet të dorëzojnë deklaratat e stafit akademik të angazhuar jo më larg se data 31 tetor”, pra IAL janë të obliguara që të deklarojnë stafin akademik më së largu deri më 31 tetor 2019. Sipas pikës 3 të nenit 30 të UA për Akreditim, “Vetëm stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA, do të konsiderohet në procesin e akreditimit/riakreditimit për vitin pasues akademik dhe stafi akademik i deklaruar dhe aprovuar nga AKA për programet ekzistuese në kuadër të procesit të monitorimit”.

Për programin Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, BA, 180 ECTS, Kolegji “Dardania” ka paraparë si bartës të programit: Mejreme Ymeri (PhD në Shkenca Filologjike, Gjuhë dhe Letërsi dhe Letërsi Angleze), Jusuf Mustafai (PhD në Shkenca Filologjike, Gjuhë Angleze), Ismail Aliu (PhD në Shkenca Gjuhësore) dhe Ismail Kamberi (PhD në Shkenca Filologjike).

Jusuf Mustafai, përmes një e-maili, ka informuar AKA-në, se nuk është i angazhuar në Kolegjin Dardania për vitin akademik 2019/2020. Për më tepër, i njëjti person ka rezultuar i deklaruar edhe në një Institucion tjetër të Arsimit të Lartë, që bie në kundërshtim me dispozitën ligjore të përcaktuar me nenin 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim.

Ismail Kamberi nuk është i deklaruar në platformën e-akreditimi për vitin përkatës akademik, pra nuk ka deklarim për vitin akademik 2019/2020 në Kolegjin Dardania, ashtu siç është e përcaktuar me Udhëzimin Administrativ.


Ky program ka 180 ECTS, dhe rrjedhimisht sipas nenit 26, pika 5.3.4 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim, për këtë program të studimit Kolegji Dardania, duhet të ketë të paktën tre staf akademik me gradën shkencore PhD me marrëdhënie të rregullt të punës nga fusha e programit të studimit. Pas largimit të këtyre dy mësimeve, programi mbetet me vetëm një bartës, Mejreme Ymeri, sepse edhe bartësi i katërt, Ismail Aliu nuk është i doktoruar në Gjuhë Angleze.

Bazuar në faktet e prezantuara më sipër dhe dispozitat ligjore të sqaruara më lartë, KSHC vendosi që në mungesë të stafit akademik për këtë program të studimit sipas pikës 5.3.4. të Nenit 26 dhe bazuar në pikën dy (2) të Nenit 21 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, të tërheq akreditimin për programin e studimit Gjuhë Angleze dhe Studime Amerikane, BA, 180 ECTS.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (Nr. 05/L-31, datë 25 maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegjit “Dardania”;
- MASHT-it;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë